

KLSH merr pjesë në aktivitetet e Post Kongresit EUROSAT zhvilluar më 22-24 maj, 2022 në Pragë

Më datë 22-24 Maj 2022, KLSH mori pjesë në aktivitetet e Post Kongresit EUROSAT organizuar në Pragë, ku u përfaqësua nga audituesit e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit: znj. Eriola Hoxha, znj. Joana Troqe dhe z. Redon Xhelilaj.

Pjesëmarrësit e Institucioneve Supreme të Auditimit patën mundësi të shkëmbejnë eksperiencat e tyre në fushën e auditimit jo vetëm nëpërmjet prezantimeve, diskutimeve por edhe pjesëmarrjes në workshop-e me tema të ndryshme me qëllim evidentimin e praktikave më të mira në menaxhimin me efektivitet, efikasitet dhe efikasitet të fondeve publike.

Në këto aktivitete, përfaqësuesit e KLSH morën pjesë në 2 workshop-e, në workshop-in me temë “Roli i auditimit në luftën kundër korrupsionit” dhe në workshop-in me temë “Auditimi i taksave”.

Pjesëmarrja në këto aktivitete, ashtu si dhe shumë aktivitete të tjera të zhvilluara në lidhje me veprimtarinë audituese me partneritetet brenda dhe jashtë vendit me SAI-t homologe, i shërben përmirësimit të qeverisjes publike në përpjekjen e vazhdueshme të KLSH-së për ngritjen e kapaciteteve audituese.



Çështjet mbi të cilat u diskutua, konsistuan në:

-Eksperiencën e secilit SAI në luftën kundër korrupsionit dhe në auditimin e taksave.

-Nxitjen e diskutimeve për të krijuar partneritet dhe bashkëpunim profesional, të nevojshëm për të qenë të suksesshëm në kryerjen e funksionit të audituesit shtetëror si dhe në:

-Sfidat e ardhshme të auditimit publik.

Post Kongres Eurosaï u mbyll me një mesazh të rëndësishëm: Në rrugën e modernizimit institucional, të ardhmen vërtet nuk mund ta kemi nën kontroll, por me përpjekje të përbashkëta dhe kolektive ne mund ta krijojmë atë në formën më të mirë të mundshme.